

EKSTRAKT NGA
STATUTI I FONDACIONIT
“NEHEMIAH GATEWAY ALBANIA”

§ Neni 1: Formimi, Qëllimi

- 1.1. Fondacioni “Nehemiah Gateway Albania” me qendër në Buçimas, është krijuar në përputhje me Aktin e Themelimit të Fondacionit, datë 21.07.1995, i ndryshuar, si dhe në përputhje me nenet 54 deri 63 të Ligjit Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” dhe Ligjit Nr.8788 datë 7.5.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” i ndryshuar.
- 1.2. Qëllimi kryesor i Fondacionit është organizimi dhe zhvillimi i një pune të gjerë në drejtim të forcimit të besimit tek Perëndia, si e vetmja rrugë për pastrimin shpirtëror të njerëzve, forcimi i edukatës dhe vlerave sociale dhe njohjen e respektimin e personalitetit njerëzor, organizimi i një arsimit privat laik dhe fetar, puna për nxitjen e frymës ndërkultore dhe ndërfetare si dhe të mirëkuptimit midis popujve, sigurimi i një ndihme materiale dhe financiare për arsimin, kulturën shëndetsinë dhe punët e tjera komunale e kombinuar kjo me sigurimin dhe organizimin e bashkësive të krishtera.
- 1.3. Për arritjen e këtyre qëllimeve, Fondacioni mban lidhje me organizata homologe, institucione dhe organizata ndërkombëtare si dhe individë të vecantë, të cilët me ndihmesën e tyre mbështesin veprimtarinë e Fondacionit, gjithmonë duke ruajtur Fondacioni pavarësinë e tij, duke zhvilluar një aktivitet të gjerë në fusha të ndryshme të veprimtarisë dhe që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij, por gjithnjë pa qëllim fitimi, dhe në rritje dhe administrimin e fondeve dhe asetëve të Fondacionit.
- 1.4. Fondacioni e ushtron aktivitetin e tij në bazë dhe në zbatim të Konventës së Lozanës të vitit 1974.

§ Neni 2: Emri, Forma, Vula, Simboli, Logo

- 2.1. Forma e kësaj organizate jofitimprurëse është fondacion.
- 2.2. Fondacioni emërtohet “Nehemiah Gateway Albania”. Emri i shkurtuar i Fondacionit është “N.G. Albania”
- 2.3. Vula e Fondacionit përbëhet nga simboli i saj i veçantë me përmbajtjen “Fondacioni NEHEMIAH GATEWAY ALBANIA” ose “N.G. ALBANIA” Shqipëri, emrin e degës së Fondacionit ku zhvillohet Projekti si dhe/ose emrin e Projektit.
- 2.4. Vula e Fondacionit shfaqet në të gjitha dokumentat zyrtare dhe/ose në korrespondencën e Fondacionit me të tretët.
- 2.5. Fondacioni ka Logon e vet e cila shfaqet në të gjitha publikimet, printimet, regjistrimet, faqet e internetit, dhe në materiale të tjera të ngjashme me këto, mbi të cilat Fondacioni ka të drejtën e autorit.
- 2.6. Logoja e Fondacionit është: (logo e printuar në një faqe të veçantë i bashkangjitet këtij Statuti).

§ Neni 3: Selia

- 3.1. Fondacioni e ka selinë dhe zyrat e tij qendrore në Komunën Buçimas, qyteti i Pogradecit.
- 3.2. Fondacioni ka të drejtë të krijojë degë dhe filiale jo vetëm në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, por edhe jashtë tij, sipas nevojave që mund t'i paraqiten.

3.3. Selia e Fondacionit mund të transferohet me vendim të Bordit Mbikëqyrës.

§ Neni 4: Kohëzgjatja

- 4.1. Fondacioni do të zhvillojë veprimtarinë e tij për një kohë të pakufizuar.
- 4.2. Fondacioni mund të shpërndalet, bashkohet apo transformohet në çdo kohë, sipas kritereve të vendosura në Aktin e Themelimit të Fondacionit dhe ato të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

§ Neni 5: Zotësia për të vepruar

Fondacioni e fiton zotësinë për të vepruar në momentin e regjistrimit në gjykatën kompetente.

§ Neni 6: Objekti i veprimtarisë

- 6.1. Fondacioni ka qëllim thellësisht bamirës, humanitar, në të mirë dhe interes të publikut si dhe në dobi të shoqërisë.
- 6.2. Për realizimin sa më të mirë dhe të plotë të qëllimeve të tij Fondacioni do të shtrijë aktivitetin e tij në këto drejtime kryesore:
 - 6.2.1. Organizimin dhe ndihmën konkrete për krijimin dhe bashkimin e Kishave të Krishtera, sidomos të Kishave Ungjillore, dhe bashkimin e komuniteteve të tjera fetare, që veprojnë në Shqipëri.
 - 6.2.2. Organizimin dhe krijimin e kurseve dhe formave të tjera të ngjashme për edukimin shpirtëror, lidhur me njohjen e Biblës, Ungjillit, të cilat konsistojnë në kujdesin pastoral, moral, biblik dhe tema të tjera të ngjashme me to.
 - 6.2.3. Nxitjen dhe mbështetjen e shkëmbimeve midis popujve për forcimin e marrëdhënieve të miqësisë dhe bashkëpunimit.
 - 6.2.4. Themelimi, organizimi dhe zhvillimi i një arsimit privat, laik dhe fetar, si dhe zhvillimi i arsimit shtetëror, i të gjitha llojeve dhe niveleve, duke investuar dhe dhënë ndihma materiale dhe financiare, do të jetë një nga drejtimit kryesore të veprimtarisë së Fondacionit.
 - 6.2.5. Hapja dhe organizimi i kurseve dhe formave të tjera të ngjashme me to, për përgatitjen profesionale në fusha të ndryshme të jetës, duke përfshirë në to të gjitha shtresat e popullsisë
 - 6.2.6. Hapja dhe organizimi i kurseve për mësimin e gjuhëve të huaja dhe njohurive të tjera në fushën e shkencës, teknikës dhe biznesit.
 - 6.2.7. Sjellja e specialistëve nga vende të ndryshme të botës për të dhënë eksperiencë në fusha të ndryshme, qoftë në formën e të punësuarve po ashtu dhe në formën e mësimdhënësve ose këshilltarëve praktikë.
 - 6.2.8. Organizimin dhe ndihmën shpirtërore dhe materiale për institucionet dhe organizatat private e shtetërore si: burgjet, shtëpitë e fëmijës dhe të institucioneve të ngjashme me to - do të jetë një drejtim tjetër në veprimtarinë e Fondacionit.
 - 6.2.9. Themelimi, organizimi dhe zhvillimi i qendrave këshillimore për probleme të ndryshme si ato shpirtërore, praktike dhe edukative, duke e kombinuar me këshilla për njerëzit në mënyrë të organizuar, për krijimin e vendeve të punës dhe në mënyrë individuale e kolektive, me dhënien e një ndihme konkrete për gjetjen e vendeve të punës, zhvillimit të biznesit, gjetjen e tregjeve për tregëtim si dhe organizimin e mënyrës së tregëtimit.

- 6.2.10. Themelimi, organizimi dhe zhvillimi i një pune të gjerë në fushën e shëndetësisë, si psh. programet e shpëtimit, emergjencës duke përfshirë transportin dhe komunikimin, hapja e ambulancave, qendrave shëndetësore, klinikave, spitaleve, farmacive dhe aktiviteteve shëndetësore të të gjitha llojeve.
- 6.2.11. Dhënia e një ndihme reale financiare dhe materiale në fushën e shëndetësisë, organizimi, çelia dhe vënia në funksionim e bibliotekave, çelia dhe riparimi i rrugëve komunale, dhënia e një ndihme konkrete materiale në fushën e bujqësisë, turizmit, shkollave private, duke ruajtur dhe duke u kujdesur për hapjen dhe funksionimin e vendeve të çlodhjes për të gjitha moshat.
- 6.2.12. Puna për botime në fusha të ndryshme të jetës, gjë që do të shprehet në përkthimin e literaturës së huaj, materialeve të shkruara, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e librave të ndryshëm, flet-palosjeve, filmave, vidoive, kasetave dhe materialeve të tjera që u shërbejnë aktiviteteve të Fondacionit dhe politikës bazë të tij.
- 6.2.13. Zhvillimi, prodhimi dhe shpërndarja e programeve të veta televizive dhe radiofonike përmes mas-medias.
- 6.2.14. Themelimi, organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të turizmit dhe i të gjitha aktiviteteve që lidhen me të, për edukimin e qytetarëve me këto aktivitete por gjithmonë brenda arritjes së qëllimit të objektit të veprimtarisë së Fondacionit.
- 6.2.15. Themelimi, organizimi dhe zhvillimi i të gjitha aktiviteteve bujqësore, gjithmonë brenda arritjes së qëllimit për të cilin Fondacioni është themeluar.
- 6.2.16. Themelimi, organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërtimore për nevoja të vetë Fondacionit, me qëllim edukimin dhe trajnimin e qytetarëve, por gjithnjë brenda arritjes së qëllimit për të cilin është themeluar Fondacioni.
- 6.2.17. Themelimi, organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike të Fondacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi, por gjithnjë brenda realizimit të qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së tij.
- 6.2.18. Të ofrojë shërbime dhe të punojë në rrjet me organizata, kisha, projekte të ndryshme, etj.
- Në kuptimin e këtij Statuti, "*Projekt*" nënkupton një punë (çdo aktivitet i planifikuar, ndërmarrje, plan, program, detyrë, veprim) që është organizuar në mënyrë të kujdesshme dhe e caktuar për të arritur një qëllim të veçantë, i bashkëfinancuar ose i vetfinancuar.
- 6.3. Të gjitha aktivitetet e mësipërme mund të zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë ku Fondacioni ka veprimtarinë e tij kryesore, por dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ku ai mund të ketë degët dhe filialet e tij.
- 6.4. Fondacioni gjatë veprimtarisë së tij bashkëpunon me organet e pushtetit qendror dhe lokal, me institucionet qendrore dhe lokale.